

Arrestohet edhe një person tjetër për të shtënat me armë javën e kaluar në Istog



07/04/2025 15:18

f

🐦

🔗

Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, Stacionin Policor në Istog, me datë 02.04.2025, rreth orës 19:00, është njoftuar se në një lokal në Istog, ka të shtëna me armë zjarri dhe një person është i lënduar.

Policia menjëherë ju ka përgjigjur rastit dhe në vendin ngjarjes janë vërejtur gjurmë gjaku në dyshtemenë e lokalit, gjithashtu një xham i dëmtuar nga shkrepija e armës.

Viktima është dërguar në QKMF-Istog, për trajtim mjekësor, ndërsa të dyshuarit janë larguar në drejtim të panjohur.

Pas një pune intensive të hetuesve të Sektorit Rajonal për Hetime, me datën 04.04.2025, është identifikuar dhe arrestuar njëri nga personat e dyshuar, ndërsa sot me datë 07.04.2025, në vazhdimësi të veprimeve hetimore është arrestuar edhe i dyshuari i dytë, tek i cili është gjetur dhe sekuestruar, një (1) armë pistoletë 7.62mm, një (1) karikator i së njëjtës armë dhe shtatë (7) copë fishekë 7.62mm.

Të dyshuarit e arrestuar pas intervistimit nga hetuesit, me urdhër të Prokurorit të shtetit janë dërguar në mbajtje për 48-orë.



Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LupaMedia



Artikuj të ngjashëm



April 7, 2025
Osmani vizitoi Ferizajn dhe Shtimen: Komuna me plot potencial dhe energji rinore

Other Links